



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P. 588/2018

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 07.09.2018 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

“Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me kualifikimin e operatorëve ekonomikë “ Shpiragu” sh.p.k dhe “Sigi” sh.p.k, në procedurën e prokurimit me Nr. Ref-67331-05-07-2018, me objekt: “*Blerje Materiale Pastrimi*”, me fond limit 4 889 417 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 21.05.2018, nga autoriteti kontraktor, Qendra Ekonomike e Zhvillimit dhe Edukimit të Femijeve Bashkia Tiranë.

Ankimues:

“W.Center” sh.p.k
Rr. “Dritan Hoxha”, Tiranë

Autoriteti Kontraktor:

Qendra Ekonomike e Zhvillimit dhe Edukimit të Femijeve,
Bashkia Tiranë
Rr. “Barrikadave”, Tiranë

Subjekte të Interesuara

“Shpiragu” sh.p.k
Rruga Yzberisht, Ish Kombinati Ushqimor Ali Kelmenti, Tiranë

“Sigi” sh.p.k
Godinë 4-katshe përballë xhamisë, Picar Vorë, Tiranë

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010 “*Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, i ndryshuar.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim dhe pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:**I***Vlerësimi paraprak*

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 08.05.2018 është publikuar nga autoriteti kontraktor, në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit me Nr. Ref-67331-05-07-2018, me objekt: “*Blerje Materiale Pastrimi*”, me fond limit 4 889 417 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 21.05.2018, nga autoriteti kontraktor, Qendra Ekonomike e Zhvillimit dhe Edukimit të Femijeve Bashkia Tiranë.

II.2. Në datën 24.05.2018 operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht për klasifikimin përfundimtar të ofertave dhe ofertuesit e skualifikuar si më poshtë:

1. “Euro Mega 2010” sh.p.k	2.821.900 lekë, skualifikuar
2. “Dimex” sh.p.k	2.850.700 lekë, skualifikuar
3. “Denisa Beshaj” sh.p.k	4.249.100 lekë, skualifikuar
4. “Atlantik 3” sh.p.k	4.398.250 lekë, skualifikuar
5. “Shpiragu” sh.p.k	4.470.260 lekë, kualifikuar
6. “Sigi” sh.p.k	4.540.090 lekë, kualifikuar
7. “W.Center” sh.p.k	4.559.550 lekë, kualifikuar

II.3. Në datën 31.05.2018 operatori ekonomik “W.Center” sh.p.k ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar kualifikimin e operatorëve ekonomikë “Shpiragu” sh.p.k dhe “Sigi” sh.p.k, në procedurën e prokurimit. Konkretisht pretendohet:

“[...]

1. Për operatorët ekonomikë “Shpiragu” sh.p.k dhe “Sigi” sh.p.k ne dyshojmë që përmbushin kriteret e pikës 2.1.1.1.1.që disponojnë një licencë/leje të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL), sipas objektit të prokurimit për tregtimin e materialeve të pastrimit.
2. Për operatorët ekonomikë “Shpiragu” sh.p.k dhe “Sigi” sh.p.k ne dyshojmë që përmbushin kriteret e pikës 2.b, që kanë paraqitur vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë për muajin prill – maj 2018.
3. Për operatorët ekonomikë “Shpiragu” sh.p.k dhe “Sigi” sh.p.k ne dyshojmë që kanë paraqitur kopje të certifikuar të bilancit 2017, të paraqitura dhe nënshkruara pranë autoriteteve tatimore përkatëse.
4. Për operatorët ekonomikë “Shpiragu” sh.p.k dhe “Sigi” sh.p.k ne dyshojmë që përmbushin kriteret për xhiro mesatare të tre viteve të fundit 2015, 2016, 2017 , e cial duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës limit të kontratës që prokurohet.
5. Për operatorët ekonomikë “Shpiragu” sh.p.k dhe “Sigi” sh.p.k ne dyshojmë që përmbushin kriteret e pikës 2.3.1. ku citohet se operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit (2015, 2016, 2017) dhe në vazhdim për vitin 2018, deri në datën e zhvillimit të tenderit, në një vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit dhe në vazhdim për vitin 2018.
6. Për operatorët ekonomikë “Shpiragu” sh.p.k dhe “Sigi” sh.p.k ne dyshojmë që përmbushin kriteret e pikës 2.2.2. mbi disponimin e 1 (një) mjet transporti, i cili do të shërbejë për transportin e materialeve të pastrimit, me masë maksimale të autorizuar 3-3.5 ton, në

pronësi të tij ose të marra me qera për transportin e mallrave objekt prokurimi, vërtetuar kjo me: leje qarkullimi, siguracionet e mjeteve, kolaudimin, leje transporti.

7. Për operatorët ekonomikë “Shpiragu” sh.p.k dhe “Sigi” sh.p.k ne dyshojmë që përmbushin kriteret në përputhje me specifikimet teknike të renditura në dokumentat e tenderit për produktet detergjent rrobash, solucion larës enësh xhel, solucion zbardhues disinfektues, ilac xhamash , solucion pllakash, solucion për pastrimin e sobave dhe solucion parketi. Për të gjitha produktet që janë ofertuar nga këta operatorë ne dyshojmë të kenë një autorizim ose një kontratë me prodhuesin për tregtimin e materialeve të pastrimit. Dyshojmë që kanë një kontratë apo një autorizim ku janë të përcaktuar emertimet e produkteve dhe kodi i prodhimit për cdo produkt sipas listës së produkteve të përcaktuar në dokumentat e tenderit. Në autorizim ose në kontratë duhet të jenë të listuar numrat e kontaktit ose adresa e email për të bërë verifikimet përkatëse mbi emërtimin e produkteve dhe kodin e prodhimit të cdo produkti. Dyshojmë që skedat teknike të produkteve janë në përputhje të plotë me specifikimet teknike të përmendura në dokumentat e tenderit.
8. Për operatorët ekonomikë “Shpiragu” sh.p.k dhe “Sigi” sh.p.k ne dyshojmë që raport analizat për produktet detergjent rrobash, solucion larës enësh xhel, solucion zbardhues disinfektues, ilac xhamash, solucion pllakash, solucion për pastrimin e sobave, sapun rrobash, sapun tualeti dhe solucion parketi të testuara në laborator nga ISHTI (Inspektoriat Shtetëror Teknik dhe Industrial) të jenë në përputhje me skedat teknike të paraqitura dhe me specifikimet e kërkuara në dokumentat e tenderit. Dyshojmë që për të gjithë produktet e përmendura më sipër të përmbushin parametrat fiziko-kimik njëkohësisht në raport analizë nga ISHTI dhe në specifikimet teknike MSDS (Material Safety Data Sheet) nga fabrika [...].”

II.4. Nëpërmjet shkresës nr. 679/4 prot., datë 01.06.2018 autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankimesit si vijon:

“ [...] Ofertat që janë vlerësuar të vlefshme, janë në përputhje me kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në dokumentat e tenderit nuk përbëjnë shkak për skualifikim. Vlerësimi, kualifikimi dhe vendimmarrja për një procedurë prokurimi, nuk mund t'i referohet dyshimeve, por verifikimit dhe analizimit të pajtueshmërisë së ofertave të paraqitura nga operatorët ekonomikë me specifikimet dhe kriteret e kualifikimit. Operatori ekonomik nuk ka dhënë asnjë provë për vërtetimin e pretendimeve (dyshimeve) të tij, ndërkohë që dokumentacioni i paraqitur në SPE dhe mostrat e dorëzuara ditën e zhvillimit të tenderit janë të depozituar pranë autoritetit kontraktor, duke krijuar mundësinë për kryerjen e verifikimeve nga ana e cdo autoriteti kompetent, në cdo kohë.

Përsa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomi ankimes nuk qëndrojnë.”

II.5. Në datën 11.06.2018 operatori ekonomik “W.Center” sh.p.k ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke parashtruar të njëjtat pretendime si edhe në autoritetin kontraktor.

II.6. Në datën 19.06.2018 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 1088/2 prot., shkresa e autoritetit kontraktor nr. 679/7 prot., datë 19.06.2018, bashkëngjitur informacioni e dokumentacioni mbi zhvillimin e procedurës së prokurimit dhe trajtimin e ankesës.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj si dhe informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “W.Center” sh.p.k se: *“Për operatorin ekonomik “Shpiragu” sh.p.k ne dyshojmë që përmbush kriteret e pikës 2.1.1.1.1.që disponon një licencë/leje të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL), sipas objektit të prokurimit për tregtimin e materialeve të pastrimit”*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 8 « *Kriteret e vecanta të kualifikimit* », “*Kapaciteti ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë*», pikat 2.1.1, rezulton se nga ana e autoritetit kontraktor është përcaktuar kriteri kualifikues si më poshtë:

“Për të provuar përmbushjen e kapaciteteve të mëposhtme, Ofertuesi duhet të dorëzojë: [...]

2.1.1 Licence/leje të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL), sipas objektit të prokurimit.”

III.1.2. Objekti i prokurimit është: *“Blerje Materiale Pastrimi”*.

III.1.3. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të shoqërisë “Shpiragu” sh.p.k, konstatohet se për përmbushjen e kriterit si më sipër cituar, kjo shoqëri ka paraqitur dokumentacionin si vijon:

- 1. Leje me nr.serial PN-6496-05-2018, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit në datën 10.05.2018., për subjektin “Shpiragu” sh.p.k, me kod III.1.A, Kategoria “Për ndikimin në mjedis”. Emërtimi përshkrues i veprimtarisë është: “Leje mjedisi e tipit C për Stacion transferimi për mbetje jo të rrezikshme.”*

III.1.4. Në nenin 46, pika 1, gërma “a” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 *“Për prokurimin publik”*, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese; kualifikimi profesional: çdo operatori ekonomik i kërkon licencat profesionale, industriale apo tregtare, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, për veprimtaritë e kërkuara dhe për të cilat do të lidhet kontrata;”*

Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”.

III.1.5. Në nenin 55, pika 2 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet 2. *Autoriteti kontraktor vlerëson dhe krahason ofertat e vlefshme, për të përcaktuar ofertën fituese, në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit. Nuk duhet të përdoret asnjë kriter, që nuk është përfshirë në dokumentet e tenderit.*

Ndërsa në nenin 27, pika 3 të VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, përcaktohet se: “Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

III.1.6 Nisur nga sa më sipër konstatuar, Komisioni gjykon se operatori ekonomik “Shpiragu” sh.p.k është në kushtet e mospërmbushjes së kriterëve të kualifikimit të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit. Autoriteti kontraktor shprehimisht ka kërkuar *Licence/leje të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL), sipas objektit të prokurimit*, ndërkohë dokumentacioni provues i paraqitur nga operatori ekonomik ankimes “Shpiragu” sh.p.k në funksion të përmbushjes së kriterit sa më sipër, dëshmon se kjo shoqëri disponon *Leje mjedisi e tipit C për Stacion transferimi për mbetje jo të rrezikshme*. Në këtë mënyrë shoqëria “Shpiragu” sh.p.k nuk ka arritur të provojë se përmbushjen e kriterit të kërkuar nga autoriteti kontraktor.

III.1.7. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor plotësimin e kapaciteteve të kërkuara në dokumentat e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor, do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit në respekt të nenit 66 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 i ndryshuar. Operatorët

ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt prokurimi. KPP sqaron se, në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën ekonomike në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi. Mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme, si edhe përbën kusht për skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit. Në këto kushte, dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “Shpiragu” sh.p.k, në procedurën e prokurimit, nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe nuk mund të konsiderohet i vlefshëm.

Rrjedhimisht, sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “W.Center” sh.p.k se: *“Për operatorin ekonomik “Shpiragu” sh.p.k ne dyshojmë që përmbush kriteret e pikës 2.2.2. mbi disponimin e 1 (një) mjet transporti, i cili do të shërbejë për transportin e materialeve të pastrimit, me masë maksimale të autorizuar 3-3.5 ton, në pronësi të tij ose të marra me qera për transportin e mallrave objekt prokurimi, vërtetuar kjo me: leje qarkullimi, siguracionet e mjeteve, kolaudimin, leje transporti”*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në shtojcën 8 « *Kriteret e vecanta të kualifikimit* », “*Kapaciteti teknik*”, pika 2.3.2, rezulton se nga ana e autoritetit kontraktor është përcaktuar kriteri kualifikues si më poshtë:

“Operatori ekonomik duhet të disponojë 1 (një) mjet transporti, i cili do të shërbejë për transportin e materialeve të pastrimit, me “masë maksimale të autorizuar” 3-3.5 ton, në pronësi të tij ose të marra me qera për transportin e mallrave objekt prokurimi. Kjo të vërtetohet me dokumentacionet: leje qarkullimi, siguracionet e mjeteve, kolaudimin, leje transporti.”

III.2.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të shoqërisë “Shpiragu” sh.p.k, konstatohet se për përmbushjen e kriterit si më sipër cituar, kjo shoqëri ka paraqitur dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Kontratë qeraje mjeti, nr.632 rep, nr.2191/1 Kol, lidhur në datën 19.05.2018 ndërmjet qiradhënësit me initiale A.Z dhe qeramarrësit (shoqëria) “Shpiragu” sh.p.k për marrjen me qera të mjetit me këto të dhëna:

Leje qarkullimi

Targa: TR6849T

Tipi: Kamion

Marka: Mercedes Benz

Nr.Shasie: WDB...72

Ngjyra: Kuqe [...]

Tonazhi/nga deri 4.6 ton.

Afati i zgjatjes së kontratës është 5 vjeçar [...].

Kjo kontratë është shoqëruar me dokumentacionin e mjetit me targë TR6849T si më poshtë vijon:

- Certifikatë regjistrimi në emër të personit të tatueshëm me initiale A.Z
- Licencë “Për transport mallrash për vete dhe të tretë brenda vendit”, lëshuar nga Bashkia Vorë për personin fizik/juridik A.Z.
- Leje qarkullimi, lëshuar për z.A.Z.
- Certifikatë e kontrollit teknik të mjetit rrugor kamion nga 3.5 deri 7.5 ton.
- Sigurimi i detyrueshëm i mjetit.
- Taksa vjetore.
- Certifikatë “Për transport mallrash për nevojat e veta brenda vendit”, lëshuar nga Bashkia Vorë për kamionin me targë TR6849T, në përdorim të personit fizik/juridik A.Z, e vlefshme deri më datën 11.04.2019.

III.2.3. Në nenin 46, pika 1, gërma "b", të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese*

b. aftësia teknike: operatorët ekonomike vertetojnë se zoterojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike , aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës [...].

Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”*.

III.2.4. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor plotësimin e kapaciteteve të kërkuara në dokumentat e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Autoriteti kontraktor, do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës

dhe në dokumentat e tenderit në respekt të nenit 66 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 i ndryshuar. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt prokurimi. KPP sqaron se, në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Bazuar në sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se nga ana e autoritetit kontraktor, në dokumentat e procedurës së prokurimit me Nr. Ref-67331-05-07-2018, me objekt: *“Blerje Materiale Pastrimi”*, me fond limit 4 889 417 lekë pa tvsh, është vendosur kushti që operatori ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit duhet të vërtetojë se disponon kapacitetin teknik për një mjet transporti, me *“masë maksimale të autorizuar” 3-3.5 ton*. Në rastin konkret rezulton se operatori ekonomik “Shpiragu” sh.p.k, në përmbushje të kërkesës së sipërcituar të autoritetit kontraktor, ka paraqitur kontratën e qerasë për mjetin me targë TR6849T, me nr.632 rep, nr.2191/1 Kol, lidhur në datën 19.05.2018 ndërmjet qiradhënësit me initiale A.Z dhe qeramarrësit (shoqëria) “Shpiragu” sh.p.k, shoqëruar me Certifikatë regjistrimi në emër të personit të tatueshëm me initiale A.Z; Licencë “Për transport mallrash për vete dhe të tretë brenda vendit”, lëshuar nga Bashkia Vorë për personin fizik/juridik A.Z; Leje qarkullimi, lëshuar për z.A.Z; Certifikatë e kontrollit teknik të mjetit rrugor kamion nga 3.5 deri 7.5 ton; Sigurimi i detyrueshëm i mjetit; Taksa vjetore; Certifikatë “Për transport mallrash për nevojat e veta brenda vendit”, lëshuar nga Bashkia Vorë për kamionin me targë TR6849T, në përdorim të personit fizik/juridik A.Z, e vlefshme deri më datën 11.04.2019.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur, konstatohet se, mjeti i transportit me targë TR6849T (me qera), për të cilën ka paraqitur edhe dokumentacionin përkatës sipas kërkesave të dokumentave të tenderit, nuk plotëson kapacitetin e kërkuar nga autoriteti kontraktor për masën e automjetit 3-3.5 ton. Sipas certifikatës së kontrollit teknik të mjetit rezulton se tipi i mjetit rrugor me targë TR6849T është kamion nga 3.5 deri 7.5 ton, ndërsa sipas dokumentit “Policë për sigurimin e detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorrike për përgjegjësinë ndaj palëve të treta”, rezulton se kapaciteti mbartës i këtij automjeti është 4600, tregues i cili konfirmohet edhe në kontratën e qirasë ku thuhet: “Tonazhi/nga deri 4.6 ton”.

Sqarojmë se, bazuar edhe në nenin 82 pika 1 të ligjit 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i RSH”*, barra e provës për të vërtetuar plotësimin e kriterit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor, bie mbi operatorin ekonomik, i cili në rastin konkret ka dështuar ta vërtetojë atë.

Sa më sipër, referuar dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik “Shpiragu” sh.p.k., ku qartësisht verifikohen të dhënat e mjetit dhe konkretisht edhe kapaciteti i mjetit, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se ky operator nuk përmbush kriterin e përcaktuar nga autoriteti kontraktor, pasi është në tejkalim të kapacitetit të kërkuar në dokumentat e tenderit.

Pretendimi i ankimuesit qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimet e tjera të ngritura nga operatori ekonomik ankimes “W.Center” shpk për skualifikimin e shoqërisë “Shpiragu” sh.p.k në procedurën e prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se për sa kohë që pretendimet e trajtuara më sipër qëndrojnë dhe gjendja faktike juridike e operatorit ekonomik “Shpiragu” sh.p.k pas arsyetimit të K.P.P do të ndryshojë duke u skualifikuar, shqyrtimi në themel i pretendimeve të tjera të ankimesit në fjalë nuk ndryshojnë gjendjen juridike të këtij subjekti e për rrjedhojë nuk do të merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

III.4. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “W.Center” sh.p.k se: *“Për operatorin ekonomik “Sigi” sh.p.k ne dyshojmë që përmbush kriteret e pikës 2.1.1.1.1.që disponon një licencë/leje të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL), sipas objektit të prokurimit për tregtimin e materialeve të pastrimit”*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.4.1. Në shtojcën 8 « *Kriteret e vecanta të kualifikimit* », “*Kapaciteti ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë*», pikat 2.1.1, rezulton se nga ana e autoritetit kontraktor është përcaktuar kriteri kualifikues si më poshtë:

“Për të provuar përmbushjen e kapaciteteve të mëposhtme, Ofertuesi duhet të dorëzojë: [...]

2.1.2 Licence/leje të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL), sipas objektit të prokurimit.”

III.4.2. Objekti i prokurimit është: *“Blerje Materiale Pastrimi”*.

III.4.3. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të shoqërisë “Sigi” sh.p.k, konstatohet se për përmbushjen e kriterit si më sipërcituar, kjo shoqëri ka paraqitur dokumentacionin si vijon:

- 1. Leje me nr.serial PN-9976-05-2015/2, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit në datën 13.05.2015., për subjektin “Sigi” sh.p.k, Kodi III.1.C, Kategoria “Për ndikimin në mjedis”, nënkategoria “Leje mjedisi e tipit A”. Emërtimi përshkrues i veprimtarisë është: “Procedurë paraprake e vlerësimit të ndikimit në mjedis për “Ndërtim magazinë produktesh higjieno-sanitare”.*
- 2. Licensë me nr.serial LN-5111-05-2018 lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit në datën 17.07.2018, për subjektin “Sigi” sh.p.k, Kodi II.1.B, Kategoria “Prodhimi dhe/ose tregtimi i ushqimeve”, nënkategoria “Shitje me shumicë e ushqimeve me origjinë shtazore (për njerëzit)”. Emërtimi përshkrues i veprimtarisë është: “Shitje me shumicë e ushqimeve me origjinë shtazore (për njerëzit)”.*

III.4.4. Në nenin 46, pika 1, gërma “a” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese; kualifikimi profesional: çdo operatori*

ekonomik i kërkon licencat profesionale, industriale apo tregtare, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, për veprimtaritë e kërkuara dhe për të cilat do të lidhet kontrata;”

Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”.

III.4.5. Në nenin 55, pika 2 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet 2. *Autoriteti kontraktor vlerëson dhe krahason ofertat e vlefshme, për të përcaktuar ofertën fituese, në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit. Nuk duhet të përdoret asnjë kriter, që nuk është përfshirë në dokumentet e tenderit.* Ndërsa në nenin 27, pika 3 të VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, përcaktohet se: “Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

III.4.6 Nisur nga sa më sipër konstatuar, Komisioni gjykon se operatori ekonomik “Sigi” sh.p.k është në kushtet e mospërmbushjes së kriterëve të kualifikimit të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit. Autoriteti kontraktor shprehimisht ka kërkuar *Licence/leje të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL), sipas objektit të prokurimit*, ndërkohë dokumentacioni provues i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “Sigi” sh.p.k në funksion të përmbushjes së kriterit sa më sipër, dëshmon se kjo shoqëri disponon Leje mjedisi tipi A dhe licencë për shitje me shumicë të ushqimeve me origjinë shtazore (për njerëzit), ndërkohë që objekti i prokurimit është blerje materiale pastrime.

Në këtë mënyrë shoqëria “Sigi” sh.p.k nuk ka arritur të provojë se përmbushjen e kriterit të kërkuar nga autoriteti kontraktor.

III.4.7. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor plotësimin e kapaciteteve të kërkuara në dokumentat e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të

papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor, do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit në respekt të nenit 66 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 i ndryshuar. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt prokurimi. KPP sqaron se, në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën ekonomike në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi. Mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme, si edhe përbën kusht për skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit. Në këto kushte, dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik "Sigi" sh.p.k, në procedurën e prokurimit, nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe nuk mund të konsiderohet i vlefshëm.

Rrjedhimisht, sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.5. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik "W.Center" sh.p.k se: *"Për operatorin ekonomik "Sigi" sh.p.k ne dyshojmë që përmbush kriteret e pikës 2.2.2. mbi disponimin e 1 (një) mjet transporti, i cili do të shërbejë për transportin e materialeve të pastrimit, me masë maksimale të autorizuar 3-3.5 ton, në pronësi të tij ose të marra me qera për transportin e mallrave objekt prokurimi, vërtetuar kjo me: leje qarkullimi, siguracionet e mjeteve, kolaudimin, leje transporti"*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.5.1. Në shtojcën 8 « Kriteret e vecanta të kualifikimit », "Kapaciteti teknik", pika 2.3.2, rezulton se nga ana e autoritetit kontraktor është përcaktuar kriteri kualifikues si më poshtë:

"Operatori ekonomik duhet të disponojë 1 (një) mjet transporti, i cili do të shërbejë për transportin e materialeve të pastrimit, me "masë maksimale të autorizuar" 3-3.5 ton, në pronësi të tij ose të marra me qera për transportin e mallrave objekt prokurimi. Kjo të vërtetohet me dokumentacionet: leje qarkullimi, siguracionet e mjeteve, kolaudimin, leje transporti."

III.5.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të shoqërisë "Sigi" sh.p.k, konstatohet se për përmbushjen e kriterit si më sipër cituar, kjo shoqëri ka paraqitur dokumentacionin e mëposhtëm për mjetin me targë TR 7695 U si më poshtë vijon:

- Certifikatë regjistrimi në emër të personit të tatueshëm "Sigi" sh.p.k
- Autorizim lëshuar në datën 02.11.2017 nga Bashkia Lezhë sipa stë cilit autorizohet përsoruesi i mjetit në pronësi të "Sigi" sh.p.k, të llojit ATP, me targë TR 7695 U, të lëvizë në rrugët e qytetit të Lezhës dhe të NJA Shëngjin [...].
- Licencë "Për transport mallrash për të tretë dhe me qira brenda vendit", lëshuar nga

Bashkia Vorë për personin fizik/juridik “Sigi” sh.p.k, e vlefshme deri më 09.06.2018.

- Leje qarkullimi, lëshuar për subjektin “Sigi” sh.p.k.
- Certifikatë e kontrollit teknik të mjetit rrugor kamion nga 3.5 deri 7.5 ton.
- Sigurimi i detyrueshëm i mjetit.
- Taksa vjetore.
- Certifikatë “Për transport mallrash për të tretë dhe me qera brenda vendit”, lëshuar nga Bashkia Vorë për mjetin ATP me targë TR 7695 U, në përdorim të personit fizik/juridik “Sigi” sh.p.k, e vlefshme deri më datën 19.06.2018.

III.5.3. Në nenin 46, pika 1, gërma "b", të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese*

b. aftësia teknike: operatorët ekonomike vertetojnë se zoterojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike , aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës [...].

Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”*.

III.5.4. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor plotësimin e kapaciteteve të kërkuara në dokumentat e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Autoriteti kontraktor, do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit në respekt të nenit 66 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 i ndryshuar. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt

prokurimi. KPP sqaron se, në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Bazuar në sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se nga ana e autoritetit kontraktor, në dokumentat e procedurës së prokurimit me Nr. Ref-67331-05-07-2018, me objekt: *“Blerje Materiale Pastrimi”*, me fond limit 4 889 417 lekë pa tvsh, është vendosur kushti që operatori ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit duhet të vërtetojë se disponon kapacitetin teknik për një mjet transporti, me *“masë maksimale të autorizuar” 3-3.5 ton*, dokumentuar me *leje qarkullimi, siguracionet e mjeteve, kolaudimin, leje transporti*. Në rastin konkret rezulton se operatori ekonomik “Sigi” sh.p.k, në përmbushje të kërkesës së sipërcituar të autoritetit kontraktor, ka paraqitur: Certifikatë regjistrimi në emër të personit të tatueshëm “Sigi” sh.p.k; Autorizim lëshuar në datën 02.11.2017 nga Bashkia Lezhë sipas të cilit autorizohet përsoruesi i mjetit në pronësi të “Sigi” sh.p.k, të llojit ATP, me targë TR 7695 U, të lëvizë në rrugët e qytetit të Lezhës dhe të NJA Shëngjin [...]; Licencë “Për transport mallrash për të tretë dhe me qira brenda vendit”, lëshuar nga Bashkia Vorë për personin fizik/juridik “Sigi” sh.p.k, e vlefshme deri më 09.06.2018; Leje qarkullimi, lëshuar për subjektin “Sigi” sh.p.k; Sigurimi i detyrueshëm i mjetit; Taksa vjetore; Certifikatë “Për transport mallrash për të tretë dhe me qira brenda vendit”, lëshuar nga Bashkia Vorë për mjetin ATP me targë TR 7695 U, në përdorim të personit fizik/juridik “Sigi” sh.p.k, e vlefshme deri më datën 19.06.2018.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur, konstatohet se mungon dokumenti që vërteton kolaudimin e tjetit me targë TR 7695 U.

Sa më sipër, referuar dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik “Sigi” sh.p.k Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se ky operator nuk përmbush kriterin e përcaktuar nga autoriteti kontraktor, pasi është në tejkalim të kapacitetit të kërkuar në dokumentat e tenderit.

Pretendimi i ankimuesit qëndron.

III.6. Lidhur me pretendimet e tjera të ngritura nga operatori ekonomik ankimues “W.Center” shpk për skualifikimin e shoqërisë “Sigi” sh.p.k në procedurën e prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se për sa kohë që pretendimet e trajtuara më sipër qëndrojnë dhe gjendja faktike juridike e operatorit ekonomik “Sigi” sh.p.k pas arsyetimit të K.P.P do të ndryshojë duke u skualifikuar, shqyrtimi në themel i pretendimeve të tjera të ankimuesit në fjalë nuk ndryshojnë gjendjen juridike të këtij subjekti e për rrjedhojë nuk do të merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar dhe nenit 23 të VKM nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, me shumicë votash

Vendos

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “W.Center” sh.p.k për procedurën e prokurimit me Nr. Ref-67331-05-07-2018, me objekt: “Blerje Materiale Pastrimi”, me fond limit 4 889 417 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 21.05.2018, nga autoriteti kontraktor, Qendra Ekonomike e Zhvillimit dhe Edukimit të Femijeve Bashkia Tiranë.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së për kualifikimin e operatorëve ekonomikë “Shpiragu” sh.p.k dhe “Sigi” sh.p.k, dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si mësipër, duke i skualifikuar këta ofertues.
3. Autoriteti kontraktor brenda 10 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “W.Center” sh.p.k.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

Nr. 1088 Protokoli,

Datë 11.06.2018

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha

Mendim Kundër

Mendim kundër i anëtarëve të Komisionit të Prokurimit Publik znj. Evis Shurdha (Kryetar) dhe znj. Enkeleda Bega (Nënkryetar), në lidhje me vendimin e shumicës.

Si anëtarë të KPP shprehim mendimin kundër arsyetimit të vendimit të rrjedhimisht dhe të dispozitivit të tij, lidhur me ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “W.Center” sh.p.k., për sa i përket çështjes me

Objekt: “Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me kualifikimin e operatorëve ekonomikë “Shpiragu” sh.p.k dhe “Sigi” sh.p.k, në procedurën e prokurimit me Nr. Ref-67331-05-07-2018, me objekt: “*Blerje Materiale Pastrimi*”, me fond limit 4 889 417 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 21.05.2018, nga autoriteti kontraktor, Qendra Ekonomike e Zhvillimit dhe Edukimit të Femijeve Bashkia Tiranë.

Pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyetojmë

I.1.Në ankesën drejtuar pranë K.P.P, operatori ekonomik ankimues “W.Center” shpk nuk parashtron fakte apo dyshime të bazuara, por ngre pretendime *a-priori* për operatorët e tjerë ekonomikë të kualifikuar.

I.2. Referuar VKM nr. 184, datë 17.03.2010, “*Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton paraprakisht ankesën nga ana formale duke verifikuar (krahas juridiksionit administrativ dhe kompetencës lëndore, legjitimitit të ankimuesit dhe respektimit afateve), edhe “elementet e domosdoshëm të ankesës, sipas përcaktimeve të nenit 17, “Forma dhe përmbajtja e ankesës”, pika 3: “*Ankesa, sipas rastit, mund të shoqërohet edhe me: a) provat dokumentare, të cilat ankimuesi kërkon të shqyrtohen nga Komisioni;*”

I.3. Bazuar në sa mësipër, gjykojmë se për të mbështetur pretendimet e tyre, ankimuesi duhet të kishin shoqëruar ankesën e tyre me prova, indicie dhe argumenta, në bazë të të cilave do të shqyrtohej ankesa. Vlen të ritheksojmë se Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ, i cili në kuptim të nenit 52 të LPP dhe nenit 64 e 65 të VKM nr. 914, datë 29.012.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, shqyrton ankesat mbi

vendimet e marra nga Autoriteti Kontraktor, pra ligjvënësi qartazi i ka ndarë detyrat dhe kompetencat e këtyre dy organeve. Pra, KPP nuk mund të marrë tagrin e KVO-së dhe të rivlerësojë në themel procedurën e prokurimit publik mbi bazën e pretendimeve a-priori të pa argumentuara të operatorëve ekonomik ankimues të cilët mund lehtësisht të ngrejë pretendime për të gjitha kriteret në dokumentat e tenderit por pa pasur asnjë provë apo indicie argumentuese se ku e bazojnë ankesën e tyre.

I.4. Operatori ekonomik ka detyrimin që ta bëjë të identifikueshëm pretendimin e tij mbi shkeljen e pretenduar, pra të evidentojë qartë dhe saktë se ku e bazon pretendimin e tij për mospërmbushjen e kriterit/kritereve nga ana e operatorëve ekonomikë të tjerë. Theksojmë se mospërmbushja e kriterit apo kushteve të vendosura nga autoriteti kontraktor mund të vijë për shkaqe të ndryshme, siç janë mosparaqitja e një dokumenti të kërkuar, ose problematika që mund të prekin dokumentin etj. Është barrë e operatorit ekonomik që të përcaktojë se në cilin fakt apo rrethanë e mbështet pretendimin e tij për mospërmbushje kriteri/kriteresh. Pra kur operatori pjesmarrës në një procedurë ankohet në lidhje me ofertat e operatorëve konkurrentë, pesha specifike e barrës për të provuar paligjshmërinë hipotetike të këtyre të fundit është e plotë dhe qëndron mbi pretenduesit.

I.5. Një ankim në total, pa argumente të arsyeshme apo indicie të qarta, mbi të gjithë apo shumicën e elementëve përbërës të ofertës së konkurrentit/konkurrentëve të kualifikuar përpara tij, do të konsiderohet abuziv, në kundërshtim me qëllimin e veprimtarisë së Komisionit, pasi cënon efikasitetin dhe shpejtësinë e procedurës së prokurimit publik dhe gjykojmë se nuk duhet të merret në shqyrtim nga KPP.

I.6. KPP është paraparë nga ligji si një *quasi* gjykatë. Si e tillë në vendimarrjen e tij, Komisioni i Prokurimit Publik zbaton parimet kryesore të së drejtës. Në këto kushte refuzojmë të vendosemi në pozitën e avokatit të ankimuesit e të investohemi mbi një ankim i cili nuk mbështetet në asnjë argument, por vetëm mbi pretendime hipotetike e dyshime të paarsyeshme.

Për rrjedhojë pretendimet e ankimuesit “W.Center” shpk nuk merren shqyrtim.

Kryetar
Evis Shurdha

Nënkryetar
Enkeleda Bega